



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 32, datë 20.11.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI I SHITESËS SË GODINËS “POLI I DREJTËSISË”, NË FUNKSION TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR MBËSHTETJEN E INFRASTRUKTURËS PËR POLIN E DREJTËSISË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i shtesës së godinës “Poli i Drejtësisë”, në funksion të Shkollës së Magjistraturës për mbështetjen e infrastrukturës për Polin e Drejtësisë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Shkollën e Magjistraturës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I DREJTËSISË

BESFORT LAMALLARI




REPUBLICA E SHQIPËRISË
- MINISTRIA E DREJTËSISË -

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



REPUBLICA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
- MINISTRIA E DREJTËSISË -

Nënshkruar më datë 15/10/2025